



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 581 / prot.

Tiranë më 26.4.2018

VENDIM

Nr. 18, datë 26.4.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 581 Prot., datë 29.03.2018, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 20.02.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. Një kopje të plotë, në format të njëjtë të njëzuar me origjinalin, të Urdhrit me Nr.675/3 prot., datë 06.06.2011, të ish-Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
2. Një kopje të plotë, në format të njëjtë të njëzuar me origjinalin, të Urdhrit me Nr.838/3 prot., datë 27.05.2011, të ish-Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 581 Prot., datë 29.03.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me anë të komunikimit elektronik, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 06.04.2018.

Autoriteti Publik, me anë të shkresës nr. B-28/1 Prot., datë 12.04.2018, ka kërkuar nga Z. saktësimin e numrit të protokollit, datës dhe lëndën përkatëse për të dy shkresat e kërkuara.

Edhe pas sqarimit nga ana e kërkuarit, Autoriteti Publik nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.

Rezulton se nga e Autoritetit Publik nuk është pretenduar për pengesa ligjore sipas nenit 17, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", por është refuzuar vënia në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Si rrjedhojë, nëse informacioni disponohet nga autoriteti publik, të procedohet me dhënien e informacionit/ dokumentacionit të kërkuar.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Z. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".



## VENDOSA:

1. Pranimin e ankimit nr. 581 Prot., datë 29.03.2018 të Z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 20.02.2018,
  - Një kopje të plotë, në format të njëjtë të njësuar me origjinalin, të Urdhrit me Nr.675/3 prot., datë 06.06.2011, të ish-Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
  - Një kopje të plotë, në format të njëjtë të njësuar me origjinalin, të Urdhrit me Nr.838/3 prot., datë 27.05.2011, të ish-Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda datës 3 . 5 .2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 26 . 4 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

